

BASHKIA TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Instituti Dekliada-Alb” Shpk.

Adresa: Nj. Bashkiake Nr. 5, Rr: “Milto Tutulani”, Nd. 4, hyrja 10, Ap.6, Tiranë

Procedura e prokurimit: Loti i Dytë: “Aktekspertizë e thelluar për objektet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, të klasifikuara sipas shkallës së dëmtimit DS 4 dhe DS 5, në Njësinë Administrative Nr.2, Njësinë Administrative Nr.7, Njësinë Administrative Nr.8, Njësinë Administrative Nr.10”.

Numri i referencës së procedurës/lotit:Nuk ka.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës (në rrugë shkresore) e zhvilluar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 26, datë 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara“, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 10.01.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Bashkinë Tiranë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”, Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” si dhe mbështetur në ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), Kreu III, neni 33, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”,(i ndryshuar), neni 36, pika 2. Kohëzgjatja e kontratës është 40 (dyzetë) ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit: 9,569,583.33 (nëntë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, miratuar me VKB Nr. 2, datë 05.02.2020 “Për një shtesë dhe ndryshim në Venimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 157, datë 26.12.2019, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”.

Publikime të mëparshme: Nuk ka.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Instituti Deklada-Alb” Shpk, NUIS K71606006A

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 9,550,000 (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 11,460,000 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

2. Operatori ekonomik “Arena MK” Shpk, NUIS L67619801Q

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 9,569,000 (nëntë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 11,482,800 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë.

3. Operatori ekonomik “Erald G” Shpk, NUIS K36306784K

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 11,500,000 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 13,800,00 (trembëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Arena MK” Shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik “Arena Mk” shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet kete te punesuar per kryejen e te gjitha sherbimeve ne objekt, te perfshire ne Licensen e shoqerise ose pajisur me license individuale, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme per stafin inxhinierik si me poshte...” pasi nuk është paraqitur dokumentacion i plotë për të gjithë stafin e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Arena Mk” shpk nuk plotëson pikën 5-8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit pasi nuk janë paraqitur Çertifikata ISO.

2. Operatori ekonomik “Erald G” Shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik “Erald G” shpk nuk plotëson pikën 5-8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper kryerjen e provave, kontrolleve dhe testeve laboratorike nga organizma kombetare/nderkombetare te akredituara. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO). Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO). Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 / ISO 45001-2018, (të vlefshme) (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS / ISO)” pasi nuk janë paraqitur Çertifikata ISO.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OPERATORIN EKONOMIK “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” SHPK me adresë kryesore Adresa: Nj. Bashkiake Nr. 5, Rr: “Milton Tutulani”, Nd. 4, hyrja 10, Ap.6, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme Çmimi total i ofertës pa TVSH: 9,550,000 (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 11,460,000 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me afat të realizimit 40 (dyzete) ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, është ofertë fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, menjehere me marrjen e këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.07.2020